

UNi

**Rekruto suksesshëm
anëtarë në UNiA!**

...A!

Unia
Weltpoststrasse 20
Postfach 272
CH-3000 Bern 15

werben@unia.ch
www.werben.uniaktiv.ch

Faleminderit për angazhimin tënd!

Ti dëshiron të rekrutosh anëtarë të rinj për Unia – ne të urojmë për këtë vendim! Me këtë veprim ti do të kontribuosh në mënyrë vendimtare për fuqizimin e Unia-s dhe forcimin e punëmarrësve në vendin tonë.

Kjo fletushkë do të të ndihmojë që të përgatitesh për një bisedë rekrutuese. Kjo i trajton të gjitha arsyet më të rëndësishme, pse ia vlen anëtarësimi në Unia. Ajo ofron përgjigje edhe për çështjet të cilat mund të shtrohen gjatë një bisede të tillë. Lexoje fletushkën me vëmendje të plotë dhe në qetësi dhe mendo se cilat janë argumente më bindëse për ty dhe nëse të kujtohen edhe argumente të tjera. Pyetjet dhe këshillat e shënuara në fund të kësaj fletushke do të duhej të të shërbenin për përgatitjen e një bisede të tillë.

Ti nuk je i obliguar që në çdo bisedë për rekrutim të diskutosh të gjitha pikat e cekura këtu. Ti do të jesh shumë më i suksesshëm nëse përqendrohesh vetëm në ato çështje për të cilat bashkëbiseduesi yt interesohet – qofshin ato Kontratat e Përgjithshme të Punës, kontributet tona për anëtarësi, apo edhe sukseset tona shoqërore.

Në këtë kuptim, ne të dëshirojmë shumë biseda interesante dhe të suksesshme.





**Kush është bashkëbiseduesi/ja yt/jote?
Çfarë jete bënë?
Çfarë është e
rëndësishme për të?**

**A është krenar me
profesionin e
vetë bashkëbiseduesi yt?
A punon me kënaqësi
ai në ndërmarrjen e vet?**

1.

**Si anëtar i Unia-s,
ti bashkëvendosë, se si
do t'i përmirësojmë ne
kushtet e punës.**

Bashkërisht për kushte më të mira pune

Për drejtësinë shoqërore duhet të luftohet vazhdimisht: në përditshmërinë profesionale, në edukim, në ndërmarrje, në kantarieret e ndërtimtarisë. Unia e udhëheq këtë luftë për çdo ditë: i vetëm, punëmarrësi është në anën e dobët. Falë Unia-s, ne mund të fitojmë së bashku.

Unia e di se cilat zgjidhje u shërbejnë vërtetë të të punësuarve. Në një bashkëbisedim të afërt me profesionistët aktivë dhe me grupet operative të Unia-s, ajo i negocion rreth 400 Kontrata të Përgjithshme të Punës gati në të gjitha degët dhe profesionet e ekonomisë private. Duke ndjekur me këmbëngulje qëllimet e punëmarrësve ajo – herët a vonë i arrin ato me sukses. Në vitet e fundit, Unia për shembull ka arritur:

- **Pensionimin e hershëm** me 60 vjet në ndërtimtari.
- **Pensionimin fleksibil** në degë të ndryshme.
- **Pagën e 13-të** të garantuar në degën e hotelierisë dhe në degën e pastrimit.
- **Paga më të larta minimale, pushime shtesë, më shumë ditë të lira të paguara** apo një **Sigurim** mbiligjor për **ditët e sëmundjes** në një varg profesionesh.

Anëtarët e Unia bashkëvendosin se cilat përmirësime duhet t'i synojë Unia në çdo degë. Me Unia ju gëzoni mbrojtje dhe mund të lidheni me koleget dhe kolegët tuaj. Kjo ia vlen.

2.

Si anëtar i Unia-s ti përfiton nga rritjet e pagave, të cilat i arrin Unia.

Më shumë për të jetuar

Dividente të larta për aksionarët, tejkalimet e Bonuseve dhe parashutat e arta për menaxherët – presioni në paga, qiratë e rritura dhe premitë për sigurime shëndetësore gjithnjë e më të larta për punëmarrësit: të pasurit pasurohen gjithnjë e më shumë, derisa gjithnjë e më shumë familje nuk dinë se si t'i paguajnë të gjitha llogaritë në fund të muajit. Kjo pabarazi materiale po e rrezikon kohezionin shoqëror në Zvicër. Unia ofron një kundërpeshë të gjithë kësaj. Ajo lufton me vendosmëri me vite të tëra kundër rrjepësve dhe për drejtësi në paga:

- Më shumë se një milion punëmarrës përfitojnë nga **rritjet e pagave**, të cilat i ka nxjerrë Unia për ta.
- Për disa qindra mijëra gra sot ka më shumë **barazi pagash**, falë Unia-s.
- Në degë të ndryshme, me të ardhura të ulëta, për pak vite Unia i ka **ngritur pagat minimale** për 50% apo më shumë.
- Me dhjetëra mijëra kontrole të ndërmarrjeve dhe kantierëve të ndërtimtarisë, sekretarët e Unia ua bëjnë jetën shumë të vështirë zbritësve të pagave dhe arrijnë që **dumpingu i pagave të dënohet**.

Anëtarët e Unia-s kontribuojnë në të gjitha degët që Unia të realizojë një drejtësi më të madhe për pagat. Ata e udhëheqin me sukses iniciativën tonë për pagat minimale, përmes së cilës ne e ndalojmë presionin mbi pagat dhe mund të bëjmë një hap të madh në drejtim të një drejtësie më të madhe për pagat.

**Pse je bërë ti vetë
anëtar i Unia-s?
Dhe pse ke mbetur aty?**

**Si është angazhuar
Unia për ty personalisht?
Ku ke përfituar ti?**

3.

**Si anëtar i Unia-s ti gëzon
një mbrojtje të gjithanshme
juridike.**

Mbrojtje dhe siguri për anëtarët e Unia-s

Nëse punëdhënësi yt ta mohon rrogën e 13-të të kontraktuar, nëse nuk t'i paguan orët e tepërta apo shtesat, përpiqet të të bëjë mobing apo pushimin për fëmijën e porsalindur e shfrytëzon për të të larguar nga puna: atëherë ky është një rast për Unia! Nganjëherë ndihmon ndërhyrja e drejtpërdrejtë e Unia-s, për ta sjellë në mendje një punëdhënësi nëpërkëmbës. Por nëse është e nevojshme, Unia u ndihmon anëtarëve edhe para gjykatës.

- Në këtë mënyrë, për çdo vit Unia i nxjerr për anëtarët e vet rreth 15 milion Franka **dëmshpërblime dhe pagesa të rrogave**.
- Në raste të largimeve masive nga puna, Unia arrin të negociojë **plane sociale** dhe dëmshpërblime në rast ndarjeje për të dëmtuarit.
- Unia udhëheq **arkën më të madhe të papunësisë** në Zvicër. Ajo është pikëkontakti i parë për të gjithë ata që janë të detyruar të tejkalojnë një fazë të papunësisë.

Anëtarët tanë gëzojnë **këshillime falas** në gjuhën e tyre për të gjitha çështjet sa i përket botës së punës. **Ndihma ligjore** në rast të ballafaqimeve në çështjet e të drejtës së punës, është po ashtu falas për ta. Anëtarët e Unia-s gëzojnë edhe kujdes dhe përcjellje personale, nëse mbeten pa punë, ndërsa arka jonë e papunësisë angazhohet që të drejtat e tyre ligjore edhe të zbatohen në mënyrë efektive. Përveç kësaj: kush dëshiron të sigurohet edhe në fushën private, atyre ne u ofrojmë edhe **mbrojtjen e shumëfishtë ligjore të Unia-s** me një çmim të posaçëm. Përndryshe, një pako të tillë mbrojtëse nuk ekziston askund tjetër!





10a

Arbeitsgruppe
10b

JUN

4.

**Si anëtar i Unia-s ti gëzon
një varg shërbimesh të
shkëlqyeshme dhe oferta
ekskluzive.**

Vetëm për anëtarët!

Përveç këtyre, Unia u ofron anëtarëve të vet edhe një varg shërbimesh të mrekullueshme dhe oferta ekskluzive, të cilat peshojnë para. Ndër më të rëndësishmet radhiten:

- **Ngritja e mëtejme aftësuese:** Ai që do të përparojë personalisht dhe profesionalisht, duhet të ngritë aftësitë vazhdimisht. Unia i këshillon anëtarët, i përkrah financiarisht me rastin e ngritjes së vazhdueshme profesionale dhe sindikale dhe ofron kurse pa pagesë.
- **Informimi:** Çdo anëtar e merr Gazetën e anëtarëve të Unia në njërën nga gjuhët e vendit. Së bashku me gazetën «Horizonte», ne rregullisht ofrojmë informata edhe në pesë gjuhë të tjera.
- **Solidariteti:** Çdo anëtar i Unia mund të kërkojë përkrahjen për ndonjë projekt me përmbajtje sociale. Kush gjendet në një situatë të rëndë sociale pa fajin e tij, po ashtu mund të përkrahet nga Unia.
- **Koha e lirë:** Oferta tërheqëse për pushime dhe lirime për Unia-pushimet dhe partneren e Unia - Reka.
- **Paratë kthehen:** Anëtarëve të Unia u kthehen kontributet profesionale, nëse këto tërhiqen nga paga – një përparësi e fortë kjo për anëtarësim në Unia!
- **Ndihmë:** Deklarimi i tatimit? Sigurimi social? Sigurimi shëndetësor? Seksioni më i afërt i Unia ju ndihmon edhe më shumë. Shërbimet shesë : Shërbime tërheqëse shitesë me çmime të lira ju ofrojnë partnerët e Unia-s, si Mobility, SBB dhe Coop-Bank.

**Çfarë di bashkëbiseduesi
yt për Unia?
Çfarë dëshiron të dijë ai?**

**Cilat përvoja në Unia
të kanë bërë ty përshtypje
të veçantë?**

5.

**Si anëtar i Unia-s ti
kontribuon për më shumë
siguri dhe drejtësi sociale.**

Drejtësi dhe siguri sociale për të gjithë.

Pa Unia dhe anëtarët e saj në Zvicër nuk do të kishte siguri të qëndrueshme sociale dhe nuk do të kishte drejtësi sociale. Sepse kjo është e mundur vetëm falë sindikatave:

- **AHV dhe shtylla e dytë** e kujdesit të pleqërisë,
- **Javë 5 ditësh** e punës,
- **Katër javë pushime** për të gjithë,
- **Pagesa e menjëhershme në rast sëmundje dhe fatkeqësie,**
- **Sigurimi në rast papunësie,**
- **Kontratat e Përgjithshme të Punës** me paga minimale të detyrueshme.
- **Masat mbrojtëse kundër zbritjes së pagave**

Unia siguron vazhdimisht këto të arritura rishtas. Ajo:

- Ka ndihmuar Referendumin kundër vjedhjes së pensioneve tek arkat e pensioneve me një fitore historike;
- Ka mbrojtur sigurimin për raste sëmundjeje dhe fatkeqësie si dhe AHV kundër synimeve reduktuese;
- ka reduktuar numrin e largimeve nga puna falë ofrimit të sigurimit për punë të shkurtuar me rastin e krizës së fundit;
- ka fituar shumicën e votimeve kundër orareve gjithnjë më ekstreme në sektorin e shitjes.

Anëtarët e Unia-s mund të bashkëvendosin për kërkesat sociale të Unia dhe përmes kësaj të përfitojnë nga arritjet tona. Sepse për të gjitha këto çështje të rëndësishme për ne, familjet tona dhe për fëmijët tanë, pa sindikatat do të vendosej kundër nesh.

6.

**Si anëtar i Unia-s ti
angazhohesh për një Zvicër,
në të cilën mund të jetohet
mirë.**

Një Zvicër, në të cilën mund të jetohet mirë.

Unia është sindikata më e madhe dhe forca më e madhe sociale në Zvicër. Me peshën e 200'000 anëtarëve të vet, ajo angazhohet për një Zvicër më të drejtë dhe më solidare. Një Zvicër në të cilën të gjithë - dhe jo vetëm rrjepësit, spekuluesit financiarë dhe tatimikësit super të pasur nga e tërë bota – mund të fitojnë një jetë të mirë.

Unia angazhohet në mënyrë të suksesshme për një Zvicër, në të cilën të gjithë kanë një mundësi të barabartë. Konkretisht, kjo do të thotë:

- Për **barazi pagash** dhe **siguri sociale**.
- Për një pajtueshmëri midis **profesionit dhe familjes**.
- Për **Integrimin** e kolegëve dhe kolegeve pa pasaportë zvicerane.
- Për një **sistem arsimor të drejtë**.
- Për një **ekonomi të qëndrueshme**, në mënyrë që ne të mos jetojmë në dëm të gjeneratave të ardhshme.

Unia është e pavarur në aspektin politik dhe fetar dhe është e hapur për të gjithë njerëzit, pavarësisht nga prejardhja e tyre. Anëtarët e Unia rrjedhin nga të gjitha kampet politike. E përbashkëta e tyre është angazhimi për të drejtat e punëmarrësve. Ata përcaktojnë se, cilat vlera dhe qëllime synon forca më e madhe sociale në Zvicër. Dhe ata kontribuojnë për një Zvicër në të cilën të gjithë ne jetojmë me dëshirë.





Këshilla për një bisedë

- 1.** Bashkëbiseduesi i jonë është në qendër të vëmendjes – me shqetësimet, interesat, dëshirat, rezervat dhe qëndrimet e tij. Ne i marrim ato seriozisht dhe nuk i nënvlerësojmë.
- 2.** Ne sqarojmë hapur qysh në fillim, për çfarë duam të bisedojmë: Anëtarësimi në Unia është një punë e mirë, një shërbim i fortë, nga i cili mund të përfitojë bashkëbiseduesi/ja ynë/jonë.
- 3.** Ne flasim thjeshtë dhe kuptueshëm. Ne u shmangemi shkurtesave dhe koncepteve specifike sindikale. Ne bindim me numra të besueshëm, suksese historike, përparësi konkrete dhe shembuj nga përvoja personale.
- 4.** Theksoj arritjet dhe përfitimet e Unia-s, pa i përçmuar organizatat e tjera dhe punëmarrësit e paorganizuar. Mos kërko falje për ato që nuk kemi mundur ende t'i arrijmë.
- 5.** Ne bëjmë pyetje për të dëshmuar për respektin tonë ndaj bashkëbiseduesit/es dhe për të zbuluar çfarë realisht i intereson atij/asaj: «Çfarë di ti për Kontratën e Përgjithshme të Punës? Si janë kushtet tua të punës? Çfarë di ti për Unia?»

- 6.** Ne mbetemi gjithmonë të sjellshëm, lëmë që bashkëbiseduesi ynë të flasë dhe dëgjojmë në mënyrë shumë intensive. Ne i pranojmë pyetjet e tyre dhe u përgjigjemi atyre në mënyrë objektive.
- 7.** Ne informohemi për KPP me e të anëtarit potencial. Nëse nuk mund të përgjigjemi në ndonjë pyetje, ne e pranojmë këtë. Ky nuk është problem – por një mundësi e mirë për të dëshmuar, se ne mund të drejtohem me pyetje tek profesionistët e Unia-s.
- 8.** Skepticizmi dhe kundërshtimet janë pjesë e kësaj. Ne i marrim ato shumë seriozisht dhe nuk i fshehim ato. Me nënpyetje, ne kuptojmë çfarë fshihet pas rezervave dhe nëse ne mund t'i bindim të pavendosurit.
- 9.** Mos e harro pyetjen e fundit: «A e plotësojmë së bashku fletëanëtarësimin?» Kjo nuk është bezdisje, por një ofertë për të ndihmuar. Nëse bashkëbiseduesi/ja kanë nevojë për më shumë kohë, ne bëjmë një propozim konkret me terminë për procedurën e ardhshme.
- 10.** Jo të gjitha bisedat rekrutuese mund të jenë të suksesshme. JO-në, ne e respektojmë – dhe pyesim nëse bashkëbiseduesi ynë është i interesuar për informacione shtesë apo do të ishte i/e interesuar për një bisedë të mëvonshme.

Me disa kundërshtime do të ballafaqohesh vazhdimisht.

Ja vlen të kesh një përgjigje të gatshme edhe për to:

- **Kundërshtimi 1:** «Ligjet dhe kontratat vlejnë edhe për mua, edhe nëse nuk jam anëtar.»

Përgjigja: Ligjet dhe kontratat kanë vlerë vetëm nëse ato zbatohen. Për këtë kujdeset Unia. Ligji i punës ty të ofron vetëm një mbrojtje minimale. KPP-në tonë të mirë me rrogën e 13-të, pagat minimale, javën 40-orësh të punës, pushimet dhe ditët e lira shtesë dhe pensionimet e para-kohshme, ne duhet t'i mbrojmë vazhdimisht, përndryshe punëdhënësit do t'i ato zhbëjnë përsëri.

- **Kundërshtimi 2:** «Në degën time nuk ka KPP – prandaj anëtarësimi mua nuk më sjell asgjë.»

Përgjigja: Pikërisht në degët pa KPP anëtarësimi në Unia është shumë me rëndësi për mbrojtjen tënde. Në anën tjetër, ne mund ta arrijmë një KPP, vetëm nëse kemi mjaft anëtarë në një degë..

- **Kundërshtimi 3:** «Ka komisione të personelit – këtu nuk ka nevojë për sindikatën.»

Përgjigja: Unia e pavarur i forcon përfaqësimet e personelit, në mënyrë që ato të mund t'i bëjnë ballë presionit të shefave tuaj dhe që të mund t'i mbrojnë vërtetë interesat e personelit.

■ **Kundërshtimi 4:** «Unë dua të mbrohem vetë»

Pikërisht për këtë është Sindikata: në mënyrë që ne të mund të mbrohemi vetë, nëse ka nevojë. Në ekonominë tonë të gjallë dhe intensive, të orientuar në profit, meritat tua të sotme, nesër nuk do të vlejnë asgjë. Ndërsa vetëm në rast konflikti të gjithë e kuptojmë se: I vetëm përballë shefave, ti je në anën e dobët. Vetëm me përkrahjen profesionale të Unia-s, ti vërtetë do të mund të realizosh kërkesat tua.

■ **Kundërshtimi 5:** «Anëtarësimi e dëmton karrierën time.»

Përgjigja: Anëtarët e sindikatës dinë më shumë dhe janë bashkëbisedues më kompetentë. Punëdhënësit inteligjentë e vlerësojnë këtë. Përveç kësaj, anëtarësimi në një sindikatë është një e drejtë themelore. Kjo nuk ka të bëjë fare me punëdhënësin dhe këtë ai nuk është e domosdoshme ta dijë.

■ **Kundërshtimi 6:** «Anëtarësimi në Unia është shumë i shtrenjtë»

Përgjigja: Me 1 % të rrogës mbrohen dhe përmirësohen 99 % – kjo është një marrëveshje shumë e mirë. Kontributin tënd Unia e cakton vërtetë në mënyrë të pavarur. Asnjë shoqatë tjetër e punëmarrësve nuk ka bërë qaq shumë për kushte më të mira të punës dhe pagat sesa Unia, askush tjetër nuk ofron qaq shumë mbrojtje dhe shërbime tërheqëse.

UNi

02/2014

